



Manual Përdorimi




I nderuar Klient,

FALEMINDERIT QË ZGJODHËT ASPIRATORIN TONË. Ky seksion përmban informacione të nevojshme që do t'ju lejojnë të përdorni me kujdes dhe efektshmëri pajisjen tuaj. Përpara instalimit të pajisjes, ju lutemi t'i lexoni udhëzimet me kujdes



Seksioni 1 Pika të rëndësishme që duhen vëzhguar para se të përdoret aspiratori



Seksioni 2 Specifikimet teknike të aspiratorit.



Seksioni 3 Përmasat teknike të aspiratorit



Seksioni 4 Diagrami elektrik i aspiratorit.



Seksioni 5 Informacion rreth lidhjes së instalimit të aspiratorit.



Seksioni 6 Informacion rreth përdorimit të aspiratorit.



Seksioni 7 Informacion rreth mirëmbajtjes së aspiratorit.

PAJISJA PRODHOHET PËR LIDHJE TË TOKËZUAR.

MOS E PËRDORNI NË PRIZË TË PATOKËZUAR.

MASA PARAPRAKE DHE ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME QË DUHEN PASUR PARASYSH




Seksioni 1

1. Lidhjet elektrike dhe instaluese duhet të bëhen nga stafi i shërbimit që është i mirëinformuar mbi këtë temë;
2. Voltazhi operues është 220-240 volt. Mos e përdorni pajisjen në voltazh më të ulët apo të lartë se ky.
3. Mos e lidhni me rrugët ku bëhet dalja e avullit nga oxhaku, tymi i gazit ose me oxhakët ku ngrihen flakët.
4. Futeni pajisjen në një prizë që ka lidhje të tokëzuar.
5. Ushqimet që marrin flakë nuk duhet të gatuhet poshtë kësaj pajisjeje.
6. Mos përdorni materiale të tjera në vend të filtrit të aluminit që ka pajisja.
7. Mos e fusni në prizë pa përfunduar instalimi i pajisjes.
8. Mos e përdorni pajisjen pa filtër alumini.
9. Mos e prekni dritën e pajisjes kur qëndron e ndezur për një kohë të gjatë
10. Mos e hiqni filtrin e aluminit kur pajisja është duke u përdorur.
11. Mos e fikni menjëherë pajisjen duke ia hequr prizën ndërkohë që është duke punuar. Fikeni nga paneli i kontrollit.
12. Pajisja duhet të pastrohet periodikisht.
13. Lartësia ndërmjet sipërfaqes fundore të aspiratorit dhe sobës duhet të jetë 65 cm për sobat elektrike, dhe 75 cm për sobat me gaz ose të kombinuara
14. Materialet e paketimit mbajini larg fëmijëve sepse mund të jenë të rrezikshme për to.
15. Ndizeni aspiratorin pasi tigani i gatimit apo çajniku të jenë vënë mbi sobë.
16. Lëreni ndezur aspiratorin edhe për 15 minuta më shumë pasi të mbaroni me gatimin apo skuqjen e ushqimeve për të pastruar ajrin në kuzhinë nga erërat dhe avujt e formuar gjatë gatimit.
17. Lini ndonjë mundësi që të keni ajër të freskët në ambientin e gatimit gjatë kohës që përdorni aspiratorin, veçanërisht kur e përdorni atë në të njëjtën kohë me furrën me gaz.
18. Nëse pajisja juaj nuk punon pa ndonjë arsye të qartë, kontaktoni shërbimin më të afërt pranë jush.
19. Kompania jonë nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për gabimet që rrjedhin nga përdorimi që nuk respekton masat paraprake të parashikuara më sipër.

SPECIFIKIMET TEKNIKE



Seksioni 2



1. Aspirator 2. Panel kontrolli 3. Filtër alumini
4. Shiriti i dritës LED 5. Trupi i aspiratorit


SPECIFIKIMET TEKNIKE TË ASPIRATORIT

GJATËSIA	520-720 mm
GJERËSIA	280 mm
LARTËSIA	254 mm
PËRDORIMI	BUTON ME SHTYPJE
THITHJA E AJRIT	450 m3
FUQIA E DRITËS	1X2W
FUQIA E MOTORIT	190W
FUQIA TOTALE	192W
DIAMETRI I TUBIT DALËS TË AJRIT	120 mm
VOLTAZHI HYRËS	220 – 240 V 50Hz

PËRMASAT TEKNIKE



Seksioni 3




Shënim: Të gjitha përmasat janë në mm.

DIAGRAMI I LIDHJES ELEKTRIKE




Seksioni 4



Buton me shtypje

DIAGRAMI I INSTALIMIT



Seksioni 5


Duke përdorur një metër, bëni një vijë të drejtë duke filluar nga sipërfaqja e furrës deri në 700+280: 990 mm nëse doni të keni një hapësirë prej 700 mm ndërmjet furrës dhe sipërfaqes së poshtme të aspiratorit. Kjo vizë duhet të jetë paralele me këndin e majtë dhe të djathtë. Bëni një vizë aksiale 67,5 mm nga qendra drejt dy anëve. Bëni një vrimë me trapan me diametër 6 mm përmes dy pikave të vizatuara. Fusni vidën zgjeruese dhe instaloni strukturën varëse.

Instalimi i tubit dytësor të aspiratorit: vizatoni një vizë 75 mm nga sipërfaqja e sipërme drejt seksionit të poshtëm. Sigurohuni që viza të jetë e barabartë me cepin e majtë dhe të djathtë. Vizatoni një vizë të gjatë 50 mm në çdo anë të vizës dhe bëni një vrimë në to. Fusni vidën zgjeruese me diametër 8 mm dhe shtrëngojeni atë deri sa të mbetet një hapësirë 2,5 mm midis traversës së diametrit të vidës dhe vidës zgjeruese. Më pas, montoni produktin në vendin përkatës dhe instalimi përfundon me instalimin e tubit të brendshëm.

Rendi i hapave:

- Hapi i parë:** Montoni në mur trupin e aspiratorit me vrimat që ka në pjesën e pasme.
- Hapi i dytë:** Montoni në mobilie dhe në trup duke vidhosur nga brenda vrimat.
- Hapi i tretë:** Montoni kapakun dhe trupin
- Hapi i katërt:** Vendosni filtrin
- Hapi i pestë:** Instalim i pjesës së brendshme të aspiratorit
- Hapi i gjashtë:** Bërja e lidhjeve elektrike

INSTALIMI:




INFORMACION RRETH PËRDORIMIT TË ASPIRATORIT



Seksioni 6-1

SHTYPNI BUTONIN E NDEZJES DUKE PËRDORUR INFORMACIONIN Funksionet e butonave janë si më poshtë:



0: Fikni pajisjen

1: Ndezja në nivelin e parë

2: Ndezja në nivelin e dytë

3: Ndezja në nivelin e tretë

 : Butoni i ndezjes dhe fikjes së llambës

Shënim: Gjatë kohës që gatueri ushqimin, shtypni butonat 1 ose 2. Për të skuqurat ose gatime të ngjashme, shtypni 3.

INFORMACION RRETH MIRËMBAJTJES



Seksioni 7-1

Përpara se të filloni procedurën e mirëmbajtjes, hiqeni produktin nga priza, ose fikni butonin e ndezjes, ose lironi ose ulni çelësin e sigurisë që dërgon rrymë energjie tek aspiratori.

Filtër alumini

Ky filtër përdoret për të kapur grimcat e vajit në ajër dhe rrjedhimisht do të bllokohet pas një farë kohe, e cila do të ndryshojë në varësi të shpeshtësisë së përdorimit të pajisjes. Rekomandojmë pastrimin e këtij filtri jo më shumë se një herë në muaj për t'u siguruar që pajisja të mos jetë e rrezikshme. Për këtë veprim, fillimisht hiqni filtrin e aluminit. Lajini filtrat me detergjent të lëngshëm enësh dhe shplajini ato, dhe pas tharjes, montojini në vendin e tyre. Gjatë larjes së filtrave të aluminit mund të vihet re ndryshim i ngjyrës. Kjo është normale dhe nuk është e nevojshme t'i zëvendësojmë filtrat. Filtri i aluminit mund të lahet dhe në lavastovilje.

Heqja e filtrit të aluminit

1. Shtyni butonin e filtrit të aluminit.
2. Më pas, uleni me ngadalë dhe tërhiqeni. Në të kundërt, filtri mund të dëmtohet. Lajeni filtrin e aluminit dhe montojeni atë sërish në vendin përkatës duke ndjekur hapat e përmendur më sipër në rendin e kundërt.

Filtër karboni (është për përdorim pa nxjerrje tymi)

Ky filtër eliminon erën e gatimit. Ai patron ajrin që qarkullon në kuzhinë në rast se nuk keni mundësi të përdorni aspiratorin. Jeta fizike e filtrit të karbonit të pajisjes skadon në varësi të shpeshtësisë së përdorimit dhe mënyrës së gatimit, dhe ajo e filtrit të aluminit në varësi të pastrimit të tij të rregullt.

Në raste të pazakonta, ai duhet të zëvendësohet të paktën çdo katër muaj.

Heqja e filtrit të karbonit:

1. Hiqni filtrin e aluminit.
2. Për të hequr filtrin e karbonit, kthejeni majtas dhe tërhiqeni drejt vetes.
3. Montoni një filtër të ri karboni.
4. Hiqni filtrin e aluminit.



Seksioni 7-2

Përdorni leckë të butë të lagur me ujë për të pastruar sipërfaqen e jashtme të aspiratorit. Mos përdorni kurrë produkte gërryese dhe gërvishtëse për pastrim. Copa duhet përdorur në të njëjtin drejtim me furçën për të shmangur gërvishtjen e cilindrit prej çeliku. Xhami i dritës nuk duhet hequr gjatë pastrimit.

KUJDES!

Ju mund të shkaktoni zjarr nëse nuk respektoni rregullat lidhur me pastrimin dhe zëvendësimin e filtrave të aspiratorit.